



**PROCESVERBAL**

Mbledhja e rregullt e **Komititetit për Politikë dhe Financa** (KPF), e mbajtur më **14.08.2024**, me fillim në orën **10:15** Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, z. **Arbër Zenuni**.

**Kryesuesi:** Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! Përshëndetje Nënkyetar, z. **Fatmir Iska**. Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtore të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, të gjithë ju të pranishëm. E hapim mbledhjen e **tetë (8)** të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2024. Në konsultim më kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë rend dite;

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej **10,000.00 €** (dhjetë mijë euro), Shoqatës “Zona e Pashtrikut”;
3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për dhënien e pronës me qira **1-15 vjet**, P-05058-0 ZK – Rahovec;
4. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-05058-0 ZK Rahovec;
5. Shqyrtimi i propozim vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale, për ndërtimin e çerdhes për fëmijë, P – 02680-1 dhe P – 02680-1, ZK-Rahovec;
6. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Rahovecit për vitin 2023;
7. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të ZKA-së;
8. Të ndryshme.

**Shtesë:**

1. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në **40 vjet**, P-00772-10, ZK-Xërxe;
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-00772-10, ZK-Xërxe;

**Kryesuesi:** Materiali është gati, për pak minuta sekretaria e kuvendit do t'ju sjellë!

**Afrim Oruqi:** Përshëndetje nënkyetar, kryesues, kolegë drejtore, anëtarë të KPF-së. Para se të vijë materiali nga sekretaria, dua t'ju njoftoj rreth pikave që ta keni më të lehtë votimin. Bëhet fjalë për zonë kadastrale në Xërxe, është vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në 40 vjet. Parcela është në Gradish te obelisku. Neve prej sipërfaqes së përgjithshme, jashtë mureve të Gradishit, te hyra, është një sipërfaqe prej më shumë se 20 ari që momentalisht përdoret për parking. Bashkë me juve do të marrim vendim që t'ju japim njerëzve në shfrytëzim, me

kusht që të mirëmbahet edhe pjesa e parcelës brenda mureve të Gradishit. Pika e dytë shtesë ka të bëjë me formimin e komisionit për zhvillimin e procedurave për dhënien e kësaj prone me qera. Sipërfaqja totale e kësaj parcele është 2 ha dhe këto 23 ari e 50m<sup>2</sup> janë jashtë mureve të Gradishit – para hyrjes te dera, deri në kufi me shtegun e ecjes. Do ta prezantojmë në projektor në mbledhjen e kuvendit.

**Burim Krasniqi:** Drejtore, nëse jepet me qera, a mbetet ndonjë hapësirë tjetër për parking në momentin që organizohet ndonjë aktivitet te obelisku? E dyta, a është përcaktuar, ose propozoj që së paku të përcaktohet se çka mund të ndërtohet aty para se të jepet me qera. Jo të ndodh që dikush ta ndërtion ndonjë depo të materialit ndërtimor. Mirë është të përcaktohet natyre se çka mund të ndërtohet aty edhe pse në parim nuk pajtohem në kuptimin e asaj që, ka shumë prona tjera private aty që janë brenda zonës së mbrojtur, që nuk mund ta bëjnë asnje aktivitet dhe tanë dikush ta merr pronën e komunës afér atij që e ka pronën private aty dhe njëkohësisht të ketë mundësi që të bon aktivitete, është pak diskriminuese dhe joparimore. Me arsyetimin e mirëmbajtjes së hapësirës së obeliskut si bazë për ta dhënë në shfrytëzim të kësaj parcele, konsideroj që komuna ka kapacitete financiare që ta ketë një kontratë të veçantë me një kompani që ka për detyrë veç mirëmbajtjen e obeliskut. Konsideroj që nuk është e arsyeshme dhe është diskriminuese për pronarët tjerët të parcelave. Këto janë procese që ju dëshironi t'i zhvilloni dhe në fund prapë fjalën e fundit e jep kuvendi komunal në seancën e rregullt.

**Afrim Oruqi:** Kërkojmë falje që nuk kemi pasur mundësi ta prezantojmë skicën. Këto 22 ari nuk e prekin hyrjen për në Gradish, as parkingun. Është komisioni që do t'i zhvillojë procedurat, d.m.th janë 23 ari, gjithashtu edhe shtegu i ecjes është jashtë këtij planifikimi. Në parim ka ide, që përvèç kritereve tjera që janë të parapara me ligj, do të caktojë edhe ide tjera që investitor kur ta bën planin investiv të biznesit, do ta ketë obligim ta bëjë edhe kyçjen – qasjen, si dhe veprimtarinë do ta caktojë komisioni që do të themelohet në kuvend. Ideja është të lejohet të ndërtohet diçka me gurë, rrasha dhe dru. Jemi në rrugë të mirë për ngushtimin e zonës ekonomike dhe zonës së mbrojtur, një takim është mbajtur dhe shumë shpejt do të hapet thirrja për takim me banorët e kësaj zone Gexhë-Xërxe, do të ngushtohet kjo zonë sipas një studimi që është bërë nga një komision prej 7 anëtarëve. Në këtë komision është e përfshirë edhe Gjakova. Me këtë ngushtim njerëzve do t'ju jepet mundësia për operim dhe ndërtim nëpër pronat e tyre. Shumë shpejt do ta kemi vendimin për ngushtimin e zonës së mbrojtur të Kanionit të Drinit të Bardhë.

**Defrim Kafexhiu:** Faleminderit kryesues! Inderuar nënkyetar, kolegë anëtarë të KPF-së, drejtore të drejtive, të pranishëm të tjerë. Zakonisht kur vijnë propozim-vendimet në kuvend, vijnë prej kërkesave të njerëzve që kanë interes për të shfrytëzuar ndonjë pronë të komunës, ose nëse komuna fillimisht e shpreh interesin që t'i jap pronat në shfrytëzim për qëllimet që ju i cekni në vendim. A ka kërkesë zyrtare në Komunën e Rahovecit për shfrytëzimin e kësaj prone? Pse duhet të jepet kjo pronë për 40 vite dhe ku është interes i komunës që kjo pronë afér zonës së mbrojtur të obeliskut të jepet në shfrytëzim?

**Afrim Oruqi:** Jemi duke vepruar njëjtë si me "Majën e Shkodranit". Qëllimi ynë është që këto prona publike komunale t'i japim në shfrytëzim te njerëzit, t'i mirëmbajmë dhe ne t'i inkasojmë disa mjete. Deri sot nuk ka kërkesa, besoj që do të ketë. Jemi në fazë të ndërrimit të një rregulloreje, sepse është shumë shtrenjtë, del më shtrenjtë pronat e komunës sesa pronat private me sistem të ujitjes.

**Defrim Kafexhiu:** Tokat që kanë sistem të ujitjes, dallojnë prej pronave si këto. Kjo pronë besoj që është shumë e shfrytëzueshme dhe do të ketë interes të njerëzve për investime – çështje biznesore. Tokat e ujitjes janë për bujqësi dhe nuk mund të krahasohen në çmim. Pyetje tjetër ishte, pse për 40 vite, a mund të jepet për 5 vjet? Kjo 40 po e ngrit një dyshim, të paktën te unë.

**Afrim Oruqi:** Jemi bazuar në praktikat e kaluara. Investorët kur dëshirojnë të investojnë, për shkak të vlerës së investimit nuk ndihen sigurt, sepse fillimi i investimit është 3-4 vjet. Përndryshe, komisionin do ta themeloni ju, 2 anëtarë i ka ekzekutivi, 2 kuvendi dhe 1 prej shoqërisë civile. Ankani është publik, kush jep më shumë – e merr. Pse 40 vite? T'i ftojmë njerëzit "hajde apliko e investo, sepse është në shfrytëzim për 40 vjet". Kjo periudhë kohore prej 40 viteve nuk është ligj, ju mund ta ndryshoni, ta rrisni dhe zvogëloni.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtore! Atëherë, nëse nuk keni diçka tjetër, a jeni të pajtimit për këtë rend dite, së bashku me pikat shtesë? Kush është "për"?... Unanimisht (5) votohet rendi i ditës për sot.

## **1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryesuesi:** A ka dikush ndonjë diskutim rreth procesverbalit? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim! Kush është “për”?... Konstatoj që me shumicë votash (5 vota “për”) votohet pika e parë e rendit të ditës.

## **2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 10,000.00 € (dhjetë mijë euro), Shoqatës “Zona e Pashtrikut”;**

**Nënkyetari:** Faleminderit i nderuar kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së, drejtore, të pranishëm. Para vetes e keni propozimin e kryetarit të komunës drejtuar KPF-së, për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 10.000€, Shoqatës “Zona e Pashtrikut”. Ndarja e këtyre mjeteve financiare ka të bëjë me ngritjen e shtatore së heroit të kombit “Tahir Sinani” në Prizren. Në këtë propozim e keni të bashkëngjitur edhe një kërkesë nga një grup vullnetar i punës, që do të kujdeset bashkërisht edhe me donatorë për ngritjen e kësaj shtatoreje. E keni edhe një historik të heroit, Tahir Sinani.

**Leonard Morina:** Faleminderit kryesues! Një pyetje, a ka ndodh kjo gjë në praktikat e mëhershme, që një komunë të ndajë mjete për ngritjen e një shtatoreje në një komunë tjeter, pa e kontestuar rëndësinë e shtatoreve.

**Nënkyetari:** Ndoshta edhe ka ndodhur, por edhe nëse jo, le të jemi ne si praktikë e parë për komunat tjera. Kësaj radhe nuk jemi komuna e vetme që ndan mjete këtu, janë edhe disa komuna tjera.

**Kryesuesi:** Faleminderit nënkyetar! A ka dikush ndonjë diskutim tjeter? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Unanimisht (6) votohet pika e dytë.

## **3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për dhënien e pronës me qira 1-15 vjet, P-05058-0 ZK – Rahovec;**

**Afrim Oruqi:** Bëhet fjalë për zonë kadastrale në Rahovec, vendin e quajtur Krajishte, me nr. 05058-0, me sipërfaqe prej 1276m<sup>2</sup>. Qëllimi ka të bëjë me ruajtën dhe rritjen e vlerës së pronës publike komunale si dhe vetëpunësimi.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! A ka dikush ndonjë diskutim tjeter? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?.. Abstenim?... Votohet pika e tretë, me 4 vota “për”, 1 kundër dhe 1 abstenim.

## **4. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-05058-0 ZK Rahovec;**

**Afrim Oruqi:** Bëhet fjalë për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për të njëjtën pronë të komunës me nr. 05058-0 ZK Rahovec. Komisioni përbëhet prej pesë anëtarëve, 2 prej tyre nga kuvendi, 2 nga ekzekutivi dhe 1 nga organizatat joqeveritare.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! A ka dikush ndonjë diskutim? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Votohet pika e katërt, me 5 vota pro dhe 1 abstenim.

## **5. Shqyrtimi i propozim vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale, për ndërtimin e çerdhes për fëmijë, P – 02680-1 dhe P – 02680-1, ZK-Rahovec;**

**Afrim Oruqi:** Është propozim i kryetarit të komunës, që të merret vendim paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë personit juridik, në këtë rast Drejtorisë për Arsim, për ushtrimin e veprimtarisë arsimore – respektivisht për ndërtimin e çerdhes për fëmijë, për zhvillimin e aktivitetave edukativohës së arsimore përfshirë fëmijët e Komunës së Rahovecit. Afër këtyre parcelave është një fushë e vogël e futbollit si dhe ambulanca e lagjes. Sipas Ministrisë së Arsimit, vendi është adekuat për ndërtimin e çerdhes përfshirë fëmijë.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! A ka dikush ndonjë diskutim tjeter? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?.. Abstenim?... Votohet pika e pestë, me 6 vota “për” dhe 1 abstenim.

## **6. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Rahovecit përvitin 2023;**

**Afrim Limani:** Faleminderit kryesues! I nderuar nënkyetar, të nderuar anëtarë të KPF-së. Fillimisht opinioni për pasqyrat financiare vjetore për Komunën e Rahovecit është i kualifikuar. Sipas opinionit të auditimit, pasqyrat financiare prezentojnë pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përpjekje me standardet ndërkombëtare të kredibilitetit për sektorin publik. Baza e opinionit të kualifikuar është kjo: Komuna kishte ekzekutuar pagesa nga investimet kapitale përvitëse përmbarimore përfshirë pagat jubilare dhe shujta në vlerë 280.000€. Kjo i bie që jemi me opinion të tillë veç përfshirë kontratës kolektive. Kësaj radhe i kemi 8 rekomandime, përvitëse dallim nga vitit e kaluar që ishin 14.

**7. Shqyrtimi i Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të ZKA-së;**

**Afrim Limani:** E thash edhe më herët që sa i përket rekomandimeve nga ZKA-ja, gjithsej janë 8 rekomandime. Prej këtyre rekomandimeve, i kemi marrë të gjitha veprimet e planifikuara dhe të gjitha rekomandimet deri në fund të vitit 2024 konsiderojmë që do të zbatohen.

**8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në 40 vjet, P-00772-10, ZK-Xërxe;**

**9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P-00772-10, ZK-Xërxe;**

**Afrim Oruqi:** Në fillim i prezentova këto pika që tani më janë shtesë dhe do të vendosen në votim, për t'u ceduar në mbledhjen e rregullt të kuvendit.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Atëherë, nëse nuk keni diçka tjeter, kush është "për"?... Unanimisht (5) votohet pika e parë shtesë. Vazhdojmë me të dytën, kush është "për"?... Votohet njëjtë unanimisht (50 edhe pika e 9-të).

**10. Të ndryshme;**

**Kryesuesi:** Jemi te pika e fundit e rendit të ditës, nëse dikush ka diçka për të thënë? Atëherë, ju falënderoj për vëmendjen dhe kontributin, shihemi në mbledhjen e rregullt të kuvendit.

**P.s.: Gjatë mbledhjes, ka pasur probleme teknike me incizim, procesverbali nuk është regjistruar fare si audio. I téri është shkruar me dorë.**

Procesmbajtësi;

Albion Krasniqi

